



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Departamenti i *Metodologjisë së Mësimdhënies* në *Fakultetin e Shkencave të Edukimit* në Universitetin e Elbasanit "Aleksander Xhuvani" për nevojat e tij për zhvillimin e procesit mësimor, për vitin akademik 2022-2023, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme

Kriteret e përgjithshme e të veçanta të konkurrimit për pozicionin e punës *personel akademik me kohë të pjesshme* janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave apo) brenda ose jashtë vendit në fushën e Pedagogjisë dhe atë të Arteve skenike me notë mesatare mbi 8.5. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jahtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Të ketë kryer kurse ose kualifikime brenda dhe jashtë vendit në fushën e mësimdhënies.
3. Preferohet të ketë botime shkencore në fushën përkatëse
4. Të ketë përvojë mësimdhënie dhe aftësi pedagogjike. Eksperenca pedagogjike preferohet të jetë e vërtetuar me dëshmi dhe/ose rekomandime të tjera dhe të jetë mbi 7 vjet (specializime apo trajnime).
5. Në rastet e pedagogëve të angazhuar gjatë viteve pranë departamentit të ketë dhe vlerësimin nga titullari i lëndës për punën e kryer dhe nga përgjegjësi i departamentit.
6. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së, e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi.
7. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jahtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqëruar përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës me gojë* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022 deri 23.09.2022**

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyma”,
Aplikim në Fakultetin e Shkencave të Edukimit
Departamenti i Metodologjisë së Mësimdhënies
Elbasan**